



opravuar

08.11.2017

[Signature]




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATE/A:	07.11.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 375/2
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor KK Prizren
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Jusuf Xhibo - U.D. i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandim për plotësim të dokumentacionit



Në bazë të Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturore, neni 6 (paragrafi 7, 8 dhe 9), dhe në bazë të Ligjit Nr. 04/L-66 për Qendrën Historike të Prizrenit, neni 5 (paragrafi 1), 6 (paragrafi 1.4, 2.3), 8, 9 (paragrafi 2), 11, 16 (paragrafi 1 dhe 2), 17 (paragrafi 1), 21 (paragrafi 3), Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren lëshon:

REKOMANDIM

Investitorit Agron Kastrati nga Prizreni, rruga "Ersan Mazreku" nr.lam. 2/4 kërkohet që të kthehet lënda për plotësim të mëtejme të dokumentacionit, ngastra kadastrale nr. 03118-0, adresa: rr. "Pushkatarët" pn., K.K. Prizren.

Bazuar në Ligjin nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, nenit 6, pikat 2.1 ndalohen aktivitetet ndërtimore apo transformuese që rezultojnë me ngritjen e një objekti të vetëm në dy apo më shumë parcela kadastrale;

Nga pala kërkohet të plotësohet projekt – propozimi me këto elemente:

- 1.1. **Situacioni i gjerë dhe i ngushtë** ku janë paraqitur kuotat e nivelit të terrenit, vija ndërtimore, pozita e saktë e ndërtesës ndaj trotuarit dhe rrugës, si dhe pozita dhe distanca e ndërtesës nga teqja Melami.
- 1.2. **Përdhesa:** Baza e përdhesës të ripunohet duke u bazuar në madhësinë e lejuar të objektit sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën të Prizrenit. Madhësia e lejuar e objektit në Zonën e VIII sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën të Prizrenit është deri në 60%. Ngastra kadastrale ku planifikohet ndërtimi ka sipërfaqen 207 m². Baza e përdhesës nuk duhet të tejkalojë sipërfaqen 124 m².
Në bazën e përdhesës të paraqitet distanca e saktë e ndërtesës nga trotuari dhe rruga;
- 1.3. **Katet:** Konzollat nuk lejohet të dalin jashtë gabaritit të parcelës. Në qoftë se në projekt parashihet dalja e konzollës në katin e parë, atëherë përdhesa duhet të largohet, në mënyrë që konzolla të jetë brenda gabaritit të parcelës.
- 1.4. **Prerjet** – në prerje të paraqiten distancat e sakta të ndërtesës në relacion me trotuarin dhe rrugën, si dhe të paraqitet distanca me Teqen Melami.


A r s y e t i m

Kërkesa e parashtruar nga investitori për ndërtim të objektit – Hotelit nga dispozicioni i këtij rekomandimi gjendet brenda kufijve të Qendrës Historike të Prizrenit, respektivisht në zonën VIII (Zona e Banimit sipas trendeve aktuale të ndërtimit) sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Qendrën Historike të Prizrenit. Në lindje të parcelës ku parashihet ndërtimi i objektit të ri gjendet Teqja e Melamive që është monument i trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përkohshme (Numër Unik 3632).

Bazuar në kompetencat e QRTK Prizrenit të caktuara sipas Rregullores për caktimin e institucioneve publike të trashëgimisë kulturore, vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në cilësinë e institucioneve kompetente (Nr. 06/2017), respektivisht sipas Nenit 14. dhe 16, Komisioni i QRTK-së (Komisioni për shqyrtim dhe vlerësim të kërkesave dhe projekteve konservuese, restauruese të trashëgimisë kulturore) ka shqyrtuar lëndën në fjalë. Pas shqyrtimit të Komisionit është vlerësuar se lënda duhet të kthehet për plotësim të mëtejme të dokumentacionit.

© prammar
14.11.2017

[Signature]



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT MINISTRY OF CULTURE, YOUTH & SPORTS	
Kushte e 20 e Ligjit Sportivke Vite 1998, 1999 Prizreni, 14.11.2017	
Nr.	375/3
Dt.	14.11.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit –Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATE/A:	14.11.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 375/3
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor KK Prizren
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Jusuf Xhibo - U.D. i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Pëlqim

Në bazë të Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturorë, neni 6 (paragrafi 7, 8 dhe 9), dhe në bazë të Ligjit Nr. 04/L-66 për Qendrën Historike të Prizrenit, neni 5 (paragrafi 1), 6 (paragrafi 1.4, 2.3), 8, 9 (paragrafi 2), 11, 16 (paragrafi 1 dhe 2), 17 (paragrafi 1), 21 (paragrafi 3), Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë në Prizren lëshon:

N n

PËLQIM

Investitorit Agron Kastrati nga Prizreni, rruga "Ersan Mazreku" nr.lam. 2/4 ipet
pajtimi për hartimin e projektit kryesor për ndërtimin e objektit – Hotelit me etazhët B+P+1,
në ngastrën kadastrale nr. 03118-0, adresa: rr. "Pushkatarët" pn., K.K. Prizren, me këto kushte:

1. Kulmi të mbulohet me tjegulla të luguara (tradicionale),
2. Dyert dhe dritaret të punohen prej druri,
3. Nuk lejohet mveshja e fasadës me qeramikë, tulla ose material plastik – alumin.

4. Kërkojmë nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor që të ketë parasysh Nenin 6, paragrafin 2.6 të Ligjit nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, ku ceket: “2. Aktivitetet e ndaluara: 2.6. aktivitetet e natyrës komerciale të cilat përfshijnë një sipërfaqe të hapësirës së brendshme më të madhe se 150m² duke përfshirë depot, punëtoritë mekanike, supermarketet dhe klubet e natës;”

A r s y e t i m

Kërkesa e parashtruar nga investitori për ndërtim të objektit – Hotelit nga dispozicioni i këtij rekomandimi gjendet brenda kufijve të Qendrës Historike të Prizrenit, respektivisht në zonën I (Zona e Tregut Tradicional) sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Qendrën Historike të Prizrenit. Në lindje të parcelës ku parashihet ndërtimi i objektit të ri gjendet Teqja e Melamive që është monument i trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përkohshme (Numër Unik 3632).

Bazuar në kompetencat e QRTK Prizrenit të caktuara sipas Rregullores për caktimin e institucioneve publike të trashëgimisë kulturore, vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në cilësinë e institucioneve kompetente (Nr. 06/2017), respektivisht sipas Nenit 14. dhe 16, Komisioni i QRTK-së (Komisioni për shqyrtim dhe vlerësim të kërkesave dhe projekteve konservuese, restauruese të trashëgimisë kulturore) ka shqyrtuar lëndën në fjalë. Pas shqyrtimit të Komisionit është vlerësuar se lënda i plotëson kushtet për tu pajisur me pëlqim për hartimin e projektit kryesor.